

3.NGRITJA DHE RUAJTJA E KAPACITETEVE NJERËZORE NË AAC 2024	Punësim i stafit në pozita sipas planit të rekrutimit	27 pozita aktuali sht në AAC	30 pozita	Akt emërimet dhe PDP	1. Kërkesat për rekrutim në MPB dhe MFT 2. Realizimi i procesit të rekrutimit	53.521, 30 Euro	TM1- TM4	ZDP dhe BNJ	Strategjia e transportit multimodal 2023-2030. Pika 6.4.
	Trajnim i stafit sipas planit për ngritje të kapaciteteve profesionale	64 % i realizuar në 2023	90%	Kompetenca profesionale e fituar për realizim të detyrave	3. Realizimi i planit të trajnimit	42.000 Euro	TM1- TM4	Të gjitha departament et	
4.AVANCIMI ZBATIMIT SISTEMIT MENAXHIMIT AAC 2024	Përgatitja e sistemit të menaxhimit në AAC për vitin 2024	Jo	Po	Raportet nga auditimet e brendshme dhe të jashtme që dëshmojnë funksionimin e sistemit të menaxhimit	1. Vlerësimi i sistemit aktual 2. Realizimi i planit për përmirësimin/ava ncimin e sistemit	160.563 ,90 Euro	TM1- TM4	Të gjitha departament et	Strategjia e transportit multimodal 2023-2030. Pika 6.4.

Z. Alban Ramabaja
UD. Drejtor i Përgjithshëm i AAC



Njësia Përgjegjëse

Z. LIBRIU ALU



SHTOJCË E PLANIT TË PERFORMANCËS PËR AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS PËR VITIN 2024

Përshkrimi narrativ i objektivave

Këto objektiva janë në përputhje me Strategjinë e transportit multimodal 2023-2030 nga MMPHI, gjegjësisht pika 6.4 Transporti ajror. Objektivat janë në përgjithësi të bazuara në Ligjin për aviacionin civil, i ndryshuar, dhe në veçanti në nenin 15 të Ligjit, ku janë të përshkruara kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së.

Objektiva 1. HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT ME AKTET NORMATIVE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE është objektiv i AAC-së në përmbushje të obligimeve që i kemi bazuar në Ligjin për Aviacionin Civil. Është obligim që të nxjerrim rregullore të zbatimit të marrëveshjes HPEA, të nxjerrim rregullore me anë të të cilave bëhet përvetësimi i Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil-ONAC si dhe me qëllim të zbatimit të politikave të aviacionit civil të MMPHI dhe legjislacionit përkatës nga fusha e aviacionit civil.

Veprimet: Gjatë vitit 2024 planifikohen të transpozohen këto rregullore të BE-së:

1. Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2023/659 e datës 2 Dhjetor 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 452/2014 në lidhje me kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operacionet ajrore të operatorëve të vendeve të treta
2. Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2023/660 e datës 2 dhjetor 2022 që përcakton rregulla të detajuara për listën e transportuesve ajrorë të ndaluar të operojnë ose që u nënshtrohen kufizimeve operationale brenda Bashkimit të përmendur në Kapitullin II të Rregullores (KE) Nr 2111/2005 të Parlamentit Evropian dhe Këshilli dhe shfuqizimi i Rregullores (KE) Nr. 473/2006 që përcakton rregullat zbatuese për listën komunitare të transportuesve ajrorë që i nënshtrohen një ndalimi operimi brenda Komunitetit të përmendur në Kapitullin II të Rregullores (KE) Nr 2111/ 2005 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit
3. Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2023/661 e datës 2 dhjetor 2022 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr 2111/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi kriteret e përbashkëta për të shqyrtuar zbatimin ose heqjen e një ndalimi operativ në nivel të Bashkimit
4. Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2023/1028 e datës 20 mars 2023 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 748/2012 në lidhje me përkufizimin e avionëve kompleksë me motor dhe duke korrigjuar atë rregullore

5. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2023/989 e datës 22 maj 2023 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 1321/2014 për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike, dhe për miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra, dhe duke korrigjuar atë Rregullore
6. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2023/1020 e datës 24 maj 2023 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 965/2012 në lidhje me operacionet e shërbimit mjekësor urgjent të helikopterëve
7. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2023/1111 e datës 6 qershor 2023 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 474/2006 në lidhje me listën e transportuesve ajrorë të ndaluar të operojnë ose që u nënshtrohen kufizimeve operacionale brenda Bashkimit
8. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2023/893 e datës 21 prill 2023 që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/340 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror
9. Rregullorja implementuese e Komisionit (BE) 2019/947 e datës 24 maj 2019 mbi rregullat dhe procedurat për funksionimin e mjeteve ajrore pa pilot
10. Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2019/945 e datës 12 mars 2019 mbi sistemet e mjeteve ajrore pa pilot dhe mbi operatorët e vendeve të treta të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot

Gjatë vitit 2024 planifikohet të nxirret kjo rregullore me kërkesa legislative vendore :

1. Rregullore për lejet e fluturimeve për/ nga Republika e Kosovës

Objektiva 2. NGRITJA DHE MIRËMBAJTJA E NIVELIT TË ZBATIMIT TË STANDARDEVE TË AVIACIONIT është objektivi e AAC-së që zbatimi i standardeve të aviacionit, të shprehura në kornizën ligjore të AAC-së të realizohet në nivelin më të lartë të mundshëm. AAC si rregullator i aviacionit civil, në mënyrë të vazhdueshme të bëjë monitorimin e nivelit të zbatimit të këtyre standardeve përmes auditimeve/inspektimeve.

Përmes këtij objektivi AAC në vazhdimësi kontribuon në ngritje të nivelit të zbatimit të standardeve. Përcaktimi i objektivave gjithnjë bëhet në mbështetje të promovimit të sigurisë dhe kulturës së drejtë të operatorët dhe komuniteti i aviacionit civil.

Veprimet:

Departamenti për Siguri dhe Cilësi:

1. Menaxhimi i ndodhive të raportuara të sigurisë

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve:

1. 25 inspektime SAFA (Auditime të sigurisë të operatorëve të huaj ajror)
2. 1 auditim Organizatës Mjekësore
3. 1 auditim LKIA (për mallëra të rrezikshme)
4. 1 auditim LKIA si organizatë trajnuese (për mallëra të rrezikshme)

Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror:

1. 3 auditime të planifikuara për ASHNA
2. 1 auditim në ASHNA si organizatë trajnuese

Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit:

1. Mbikëqyrja ekonomike vjetore të LKIA për 2023
2. Mbikëqyrja ekonomike vjetore të Exfis për 2023
3. Mbikëqyrja ekonomike vjetore të ASHNA për 2023
4. Inspektim në ASHNA sa i përket zbatimit të Vendimit të AAC mbi tarifën terminale të navigacionit 2024

Departamenti i Aerodromeve:

1. 4 inspektime të planifikuara për LKIA;
2. 1 inspektim i planifikuar për LKIA Shërbimet në tokë;
3. 1 Inspektim i planifikuar për LKIA ,ExFis.

Objektiva 3. NGRITJA DHE RUAJTJA E KAPACITETEVE NJERËZORE NË AAC. Është objektive për AAC-në që ngritja dhe ruajtja e kapaciteteve të jenë gjithnjë të kënaqshme, sepse vetëm në këtë mënyrë AAC mund të realizojë detyrat dhe përgjegjësitë që mbanë dhe rrjedhimisht kjo është mënyra e vetme për të garantuar menaxhimin e sigurisë së aviacionit civil në vend AAC ka obligim ligjorë të sigurojë se institucioni është i mbështetur nga personeli i mjaftueshëm dhe i kualifikuar si dhe i pajisur me burime të mjaftueshme financiare për menaxhimin e sigurisë.

Veprim: 1. Realizimi i planit të rekrutimit për pozitat e lira të miratuara
2. Realizimi i planit të trajnimeve të personelit

Objektiva 4. AVANCIMI I ZBATIMIT TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT NË AAC. Është objektive e AAC-së që të avancojë dhe mirëmbajë sistemin e menaxhimit brenda organizatës. Ky sistem, përveç që është obligativ për AAC-në, është edhe i domosdoshëm për arritje të objektivave përmes përshtatjes dhe zbatimit të përpiktë të proceseve të punës, detyrave dhe përgjegjësiave për pozitat e punës, planifikimit, matjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Sistemi i menaxhimit është kërkesë ligjore nga Agjencioni Evropian i Sigurisë së Aviacionit-EASA përmes një numri Rregulloresh dhe gjithashtu shumë kërkesa për këtë sistem burojnë nga Shtojca 19 nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil-ONAC.

- Veprim:**
1. Vlerësimi i sistemit aktual
 2. Realizimi i planit për përmisimin/avancimin e sistemit